



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE - DEGA E GJYKATËS LIPJAN

Numri i lëndës: 2022:064594

Datë: 28.08.2024

Numri i dokumentit: 06095294

P.nr.127/22

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË DEGA NË LIPJAN, në përbërje prej gjyqtarit të vetëm gjykues Avdirrahman Gashi, duke vendosur në çështjen penale, ndaj të pandehurve Q. M., F. M., A. M., nga M., G. H. nga fsh. T., G. Z., E. Z. dhe A. Z. nga fsh. R., të akuzuar nga Prokuroria Themelore në Prishtinë PP.II.nr.4216/2021, të datës 24.03.2022, për shkak të veprës penale Pjesmarrja në rrahje dhe në bashkëkryerje Asgjësimi apo dëmtimi i pasurisë nga neni 321 par.2 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, jashtë shqyrtimit gjyqësor me dt.28.08.2024 mori këtë:

A K T V E N D I M

HUDHET aktakuza e PTH-Prishtinë, PP.II.nr.4216/2021 , të datës 24.03.2022.

I.APROVOHET marrëveshja për ndërmjetësim Nd.nr.31/24, e datës 26.08.2024, e lidhur në mes të Q. M., F. M., A. M., nga M., G. H. nga fsh. T., G. Z., E. Z. dhe A. Z. nga fsh. R., dhe të dëmtuarit F. K. nga L. e lidhur në Gjykatën Themelore në Prishtinë- Dega në Lipjan.

II.HUDHET aktakuza e Prokurorisë Themelore në Prishtinë PP.II.nr. 4216/2021 , të datës 24.03.2022.

III.PUSHOHET procedura penale kundër të pandehurve Q. M., F. M., A. M., nga M., G. H. nga fsh. T., G. Z., E. Z. dhe A. Z. nga fsh. R., për shkak të veprës penale Pjesmarrja në rrahje dhe në bashkëkryerje Asgjësimi apo dëmtimi i pasurisë nga neni 321 par.2 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, për shkak se të njëjtit kanë arritur marrëveshje të ndërmjetësuar.

IV. Shpenzimet e procedurës penale bien në barrë të mjeteve buxhetore të kësaj gjykate.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prishtinë, me aktakuzën e saj PP.II.nr.4216/2021, të datës 24.03.2022 i ka akuzuar të pandehurit Q. M., F. M., A. M., nga M., G. H. nga fsh. T., G. Z., E. Z. dhe A. Z. nga fsh. R., për shkak të veprës penale Pjesmarrja në rrahje dhe në bashkëkryerje Asgjësimi apo dëmtimi i pasurisë nga neni 321 par.2 lidhur me nenin 31 të KPRK-së. Palët prate pandehurit dhe i dëmtuari kanë propozuar që kjo çështje të dërgohet në procedurën e ndërmjetësimit dhe gjykata me dt.26.08.2024 e ka referuar rastin në procedurën e ndërmjetësimit.

Me datën 26.08.2024, në Gjykatën Themelore në Prishtinë- Dega në Lipjan, është lidhur marrëveshja për zgjidhjen e ndërmjetësuar ndërmjet të pandehurve Q. M., F. M., A. M., nga M., G. H. nga fsh. T., G. Z., E. Z. dhe A. Z. nga fsh. R., për shkak të veprës penale Pjesmarrja në rrahje dhe në bashkëkryerje Asgjësimi apo dëmtimi i pasurisë nga neni 321 par.2 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, në prani të zyrtarit së ndërmjetësimit të autorizuar nga institucioni i ndërmjetësimit ndërmjetsuesit Ali Gashi.

Në seancën e ndërmjetësimit palët kanë arritur marrëveshjen me vullnetin e tyre të plotë dhe nuk kontestojnë asnjërën nga pikat e lartshënuara për të cilat pajtohen njëzëri.

Gjykata Themelore në Prishtinë Dega në Lipjan, me datën 26.08.2024, ka pranuar marrëveshjen e palëve me numër Nd.nr.31/24, të nënshkruar me të datën 26.08.2024, për zgjidhjen e ndërmjetësimit.

Gjykata duke u bazuar në provat si më lartë dhe në bazë të nenit 229 par.5 të KPPK-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË DEGA NË LIPJAN
P.nr.127/22 të datës 26.08.2024

Bashkëpunëtorja profesionale
Gentiana Dakaj

Gjyqtari
Avdirrahman Gashi

UDHEZIM JURIDIK: Kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesa.